



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 635, datë 29.7.2020

PËR

**MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT
ME SHKËMBIM NOTASH, NDËRMJET KËSHILLIT
TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE BASHKIMIT EVROPIAN, PËR PROJEKTIN “EU4SCHOOLS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit me shkëmbim notash, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, për projektin “EU4SCHOOLS”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ERION BRACË

MINISTRI I SHTETIT
PËR RINDËRTIMIN

ARBEN AHMETAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
MINISTËR SHTETI PËR
RINDËRTIMIN

Nr. 3908 prot.

Tiranë, më 28. 7 2020

Sh.T.Z. Luigi SORECA
Ambasador i Delegacionit të Bashkimit European
ABA Business Center, Rr. Papa Gjon Pali II, Kt. 17, Tiranë

Subjekti: Financimi i Programit EU4Schools

I nderuar Ambasador,

Në emër të Qeverisë Shqiptare dëshiroj t'Ju shpreh mirënjohjen tonë për mbështetjen që Bashkimi European i ka dhënë Shqipërisë në përgjigje të tërmetit të 26 Nëntorit 2019 dhe t'Ju falënderoj Ju personalisht për angazhimin dhe ndjekjen e projekteve të dakordësuara mes palëve.

Në përgjigje të letrës Suaj mbi grantin e parë të akorduar nga Bashkimi European në vlerën 15 milionë Euro për financimin e Projektit "EU4Schools", i cili do të implementohet nga UNDP dhe do të mundësojë rikonstruksionin e 16 objekteve arsimore dhe rindërtimin e 6 të tjerave, Qeveria Shqiptare shprehet parimisht dakord me parimet e dakordësuara mes palëve, si një platformë e rëndësishme për të garantuar implementimin e suksesshëm të projektit:

1. Projekti do të zbatohet në koordinim të plotë me Qeverinë Shqiptare (përfshirë Komisionin Shtetëror për Rindërtim).
2. Procesi i prokurimit dhe zbatimi i projektit do të ekzekutohet nga UNDP në përputhje me standardet shqiptare dhe standardet e Bashkimit Evropian.
3. Mbikëqyrja e punimeve do të realizohet nga UNDP dhe do të merret në dorëzim nga bashkitë Durrës, Krujë, Kurbin, Kamëz, Kavajë.

4. Të gjithë detyrimet ligjore dhe detyrimet ndaj palëve të treta në sheshet e ndërtimit mbeten përgjegjësi e autoriteteve kompetente, përkatësisht bashkive.
5. Bashkitë respektive do të marrë përsipër të garantojë vendosjen në dispozicion të donatorit, të sheshit të ndërtimit. Nëse ka probleme me zonimin dhe pronësisë, do të zgjidhen nga autoritetet kompetente.
6. Bashkitë respektive do të marrin përsipër t'i garantojnë vendosjen në dispozicion të donatorit, të gjithë dokumentacionit të nevojshëm (leje, licenca autorizime etj.) për kryerjen e punëve.
7. Granti që siguron burimet për projektin i nënshtrohet të gjitha dispozitat ligjore në fuqi për përjashtimet përkatëse fiskale, në rast të fatkeqësive natyrore, në kuadër të procesit të rindërtimit.

Nota Juaj dhe kjo notë e përgjigjes në të cilën shprehet miratimi i Qeverisë Shqiptare, do të përbëjnë një marrëveshje me shkëmbim notash ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit European për projektin "EU4Schools", e cila do të hyjë në fuqi në datën e marrjes nga Bashkimi European të njoftimit të shkruar nga pala shqiptare, për përfundimin e procedurave të nevojshme të brendshme ligjore për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

Sinqerisht,

MINISTER

Arben AHMETAJ



NR.PROT. 3908/1
DATË 3.8 2020

MINISTRIT TË SHTETIT PËR RINDËRIMIN
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjell AGAÇI

